



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 273/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosja (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të vendosjes së posterit në objekte publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizja Vetëvendosja (LVV), dega në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datë 17.10.2013, nga subjekti politik LVV, dega në Prishtinë, në të cilën ankesë pretendohet se me datë 16.10.2013, rreth orës 12:00, në Bulevardin Bill Clinton në Prishtinë amtarë të Partisë Demokratike të Kosovës dega në Prishtinë, ka vendosur posterin e kandidates në Objektivin e Stacionit të Autobusëve në Prishtinë. Parashtrues i ankesës pretendon se është bërë shkelje e nenit 33 pika b të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme neni 3 pika b e Kodit të Mirsjëlljes për subjekte politike dhe neni 3.4 të rregullës Zgjedhore 13/2013.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP- konstatoi se pretendimet ankimore se subjekti politik PDK ka vendosur posterat e kandidates së tyre në objektin e stacionit të autobusëve në Prishtinë, nuk qëndrojnë nga dëshmitë e ofruara nuk ka qenë e mundur të identifikohet se në çfarë objekti është vendosur posterit i kandidates të subjektit politik PDK, siç pretendohet në ankesë, andaj një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante duke u

duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 273/2013 më datën 25.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë Juridike: PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*